



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË / OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISTINU / MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj. 16934/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Islam Spahiu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 27.09.2010 merrë këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Islam Mustafë Spahiu, i lindur më 1962 në Optorush K. Rahovec, me profesion këshilltari i ministrit në ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin, i gjendjes së mirë ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse nuk e ka deklaruar pasurin për vitin 2009 deri me dt të 31.03.2010 në Agjensionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë, Me veprim të tillë ka kryer vepër kundërvajtëse nga **16 paragrafi 1.1 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**, andaj për këtë:

G J O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) Euro, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirollogarin rrjedhëse 1000430070000518, nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zavendsohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.
 Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.
 Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjensioni Kundër Korrupsionit, parashtror kërkesën nr.01/2277/10 të dt.08.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur.
 Gjatë procedurës i pandehuri Islam Spahiu në deklarate tij pohoj se është e vërtetë se jam i emëruar si Ministren në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin, në Gjermani jetoj që 19 vite dhe faktikisht me rastin e emërimit tim në këtë post kam qenë në Gjermani, nga Ministria e punëve të jashtme në Kosovë, nëpërmjet imeles është tentuar të na dergohet një informat, dhe fermullar për ta deklaruar pasurin si person i lartë zyrtar, mirëpo për shkak të pengesave teknike, informata nuk ka arritur, serisht Ministria ka derguar informata dikun një javë para datës 31.03.2010, gjë që është fakt se këtë e kam pranuar, mirëpo nga ngarkesa e madhe e punës rreth përbërjes dhe vendosjes punëtorëve të kësaj Ministrie si dhe punëtorëve të Konuzllatës, është fakt se publikimi im për deklarimin pasurisë ka mbetur anësh kjo është arsya pse nuk e kam deklaruar pasurin. Përndryshe nuk kam pasur ndonjë arsye tjetër. Kurse deklarimit të pasurisë për vitin 2009 askush nuk na ka informuar se duhet me lajmur pasurin.
 Me kërkesën e ushtruar si dhe marrjen në pyetje të pandehurin, Gjyqtarja në tërësi vërtetoi që i pandehuri ka bërë kundërvajtje me të cilën e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksë.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Hatëme Ajvazi

